



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë

Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine - Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade

**UDHËZIM ADMINISTRATIV (MINT) Nr. 10/2023 PËR CAKTIMIN E KUSHTEVE PËR VENDOSJEN NË TREG TË
PRODUKTEVE TË PARAFABRIKUARA TË BETONIT - ELEMENTET E MUREVE MBAJTËSE**

Ministrja e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë,

Në mbështetje të nenit 50 të Ligjit nr. 06/L-033 për Produkte të Ndërtimit (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 21 / 05 Dhjetor 2018), nenit 11 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.08/L-117 Për Qeverinë e Republikës së Kosovës, shtojca 12 e Rregullores (QRK) - Nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, si dhe nenit 38 paragrafi 6 të Rregullores e Punës së Qeverisë Nr. 09/2011 (Gazeta Zyrtare Nr.15/ 12.09.2011),nxjerr:

Miraton:

UDHËZIM ADMINISTRATIV (MINT) Nr. 10/2023 PËR CAKTIMIN E KUSHTEVE PËR VENDOSJEN NE TREG PRODUKTEVE TË PARAFABRIKUARA TË BETONIT - ELEMENTET E MUREVE MBAJTËSE

**Neni 1
Qëllimi**

Me këtë Udhëzim Administrativ përcaktohen kërkesat teknike specifike për vendosjen e elementeve të mureve mbajtëse si produkte të parafabrikuara të betonit në tregun e Republikës së Kosovës.

**Neni 2
Fushëveprimi**

Ky Udhëzim Administrativ përcakton specifikimet teknike të elementeve të mureve mbajtëse si produkte të parafabrikuara të betonit dhe sistemin që aplikohet për vlerësimin dhe verifikimin e qëndrueshmërisë së performancës (AVCP), procedurën me të cilën deklarohet performanca si dhe kërkesat për shënjimin e këtyre produkteve me shenjën e konformitetit.

**Neni 3
Kërkesat për vendosjen në treg të elementeve të mureve mbajtëse si produkte të parafabrikuara të betonit**

1. Elementet e mureve mbajtëse si produkte të parafabrikuara të betonit, përveç atyre të cilat bartin shënjin CE, do t'i nënshtrohen kërkesave të mëposhtme:

1.1. Elementet e mureve mbajtëse si produkte të parafabrikuara të betonit duhet të jenë në përputhje me kërkesat e standardit SK EN 15258:2019: produktet e parafabrikuara të betonit - elementet e mureve mbajtëse, ose standardet ekuivalente, dhe kërkesat e standardit SK EN 13369: Rregulla të përgjithshme për produktet e betonit të parafabrikuara (*versionet e fundit qe përfshijnë çdo amendamentim apo korrigjim*).

1.2. Prodhuesi duhet të hartojë deklaratën e performancës duke përdorur modelin e përcaktuar në Shtojcën 1 të Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2019 për Kërkesat Themelore për Punimet e Ndërtimit, Deklaratën e Performancës së Produkteve të Ndërtimit, Sistemet e Vlerësimit dhe Verifikimit të Qëndrueshmërisë Performancës të Produkteve të Ndërtimit dhe Publikimin e Deklaratës së Performancës në Ueb Faqe.

1.3. Karakteristikat dhe nivelet/klasat e performancës të detyrueshme deklarohen nga prodhuesi pajtim me Shtojcën 1 të këtij Udhëzimi Administrativ.

1.4. Karakteristikat ose nivele/klasa të performancës opsionale mund të deklarohen sipas zgjedhjes së prodhuesit, në pajtim me Shtojcën 2 të këtij Udhëzimi Administrativ.

1.5. Sistemi për vlerësimin dhe verifikimin e qëndrueshmërisë së performancës është si në vijim:

	Karakteristika(t)
Sistemi AVCP 2+ sipas Shtojcës III të këtij Udhëzimi Administrativ, Deklarata e performancës e prodhuesit	Sipas Shtojcës 1 dhe 2 e këtij Udhëzimi Administrativ

1.6. Produktet që përputhen me këto dispozita duhet të shënjohen me shenjën CE (nëse prodhuesi ka përdorur një ose më shumë Trupa të Notifikuara), shenjën e konformitetit të Kosovës (nëse prodhuesi ka përdorur një ose më shumë Trupa të Emëruara), ose shenjën ekuivalente të konformitetit nga një shtet tjetër në pajtim me legjislacionin në fuqi për shenjën e konformitetit.

1.7. Prodhuesit duhet të sigurohen që të gjitha testimet janë kryer nga laboratorit testues i akredituar (përfshirë testet e kryera nga ai vet) janë plotësisht në përputhje me kërkesat e standardit të aplikueshëm të produktit, se sistemi i duhur AVCP është zbatuar dhe që performanca është deklaruar në përputhje me Shtojcat 1 dhe 2 të këtij Udhëzimi Administrativ.

Neni 4

Ndryshimet në dispozitat e hyrëse dhe Shtojcës ZA të SK EN përkatës për vendosjen në treg të elementeve të mureve mbajtëse si produkte të parafabrikuara të betonit

1. Derisa versioni Evropian i EN 15258:2008, apo standardi kombëtar i adaptuar të ndryshohet, duke marrë parasysh dispozitat e Rregullores së BE-së për produktet e ndërtimit dhe/ose ligjit, dispozitat e mëposhtme të dhëna në Shtojcën ZA të standardeve të publikuara do të zëvendësohen me sa vijon:

1.1. referencat për “Direktivën (at)” dhe “Direktivën e produkteve të ndërtimit” në Parathënie zëvendësohen me “Rregulloren (t) dhe / ose Direktivat” dhe “Rregulloren e Produkteve të Ndërtimit”;

1.2. të gjitha referencat në “Direktivën e produkteve të ndërtimit” dhe “89/106 / EEC” do të zëvendësohen me “Rregulloren për Produkte të Ndërtimit” dhe “ 305/2011/EU”,

1.3. “Kërkesa të tjera dhe direktiva të BE-së, të cilat nuk ndikojnë në qëndrueshmëri për përdorimin e qëllimshëm”, në *PARALAJMRIMIN* e ZA.1 do të zëvendësohen me “Kërkesa të tjera dhe legjislacionin e BE-së, që nuk lidhen me performancën e produkteve”;

1.4. të gjitha referencat për “atestimin e konformitetit” dhe “testimin e llojit fillestar” në ZA.2 do të zëvendësohen me “vlerësimin dhe verifikimin e qëndrueshmërisë së performancës” dhe “përcaktimit të testimit të llojit të produktit”;

1.5. „ZA.2.2 Deklarata e Konformitetit” nuk do të zbatohet. Do të hartohet një deklaratë e performancës (DeP) në përputhje me modelin e dhënë në Udhëzimin Administrativ 03/2019;

1.6. shembulli i shenjës CE i përcaktuar në figurat ZA.1 dhe ZA.2 të ZA.3 nuk do të zbatohet. Duhet të respektohen kërkesat për shënimin e CE të Rregullores së BE-së për Produktet e Ndërtimit, ose kërkesat sipas legjislacionit në fuqi për shenjën e konformitetit.

Neni 5 Shtojcat

1.Shtojca 1, 2, dhe 3 janë pjesë përbërëse e këtij Udhëzimi Administrativ:

1.1 Shtojca 1: Karakteristikat e detyrueshme (të deklarohen për të gjitha produktet);

1.2 Shtojca 2: Karakteristikat opsionale (të deklarohen sipas zgjedhjes së prodhuesit);

1.3 Shtojca 3: Sistemi i Vlerësimit dhe Verifikimit të Qëndrueshmërisë Performancës

Neni 6 Mbikëqyrja inspektuese

Dispozitat e këtij Udhëzimi Administrativ mbikëqyren nga Inspektorati i Tregut, në përputhje me ligjin për produktet e ndërtimit dhe legjislacionin përkatës për mbikëqyrjen e tregut.

Neni 7 Dispozita Kalimtare

1. Deri në hyrjen në fuqi të nënparagrafit 1.5, paragrafit 1 nenit 3 të këtij Udhëzimi Administrativ, duhet të zbatohet sistemi për vlerësimin dhe verifikimin e qëndrueshmërisë së performancës, si në vijim:

	Karakteristika(t)
Sistemi AVCP 4, Deklarata e performancës e prodhuesit	Shtojca 1 e këtij Udhëzimi Administrativ

2. Paragrafi 1 i këtij neni zbatohet dy (2) vite pas hyrjes në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ.

Neni 8 Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi gjashtë (6) muaj ditë pas nënshkrimit nga Ministrja e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë dhe publikimit në “Gazetën Zyrtare” të Republikës së Kosovës.

Rozeta HAJDARI

Ministre

Prishtinë, 27.09.2023

Shtojca I

Karakteristikat e detyrueshme (të deklarohen për të gjitha produktet)

Karakteristikat thelbësore		Klauzolat e kërkesave në standardin 15258 ZA.1- Klauzolat përkatëse për elementet e murit mbajtës		Nivelet dhe/ose klasat	Shënime dhe njësi
Rezistenca në shtypje (e betonit)	Të gjitha metodat	4.2	Kërkesat e prodhimit	-	N/mm ²
Rezistenca përfundimtare e tërheqjes dhe elasticitetit (e çelikut)	Të gjitha metodat	4.1.3 4.1.4	Çeliku përforcues dhe Çeliku paranderues i EN 3369:2004	-	N/mm ²
Përshkueshmëria nga uji (aty ku është e nevojshme)	Të gjitha metodat	4.3.8.2	Përshkueshmëria e avullit të ujit	-	Kg/(m ² x s x Pa)

Shtojca II

Karakteristikat opsionale (të deklarohen sipas zgjedhjes së prodhuesit)

Karakteristikat themelore		Klauzolat e kërkesave në standardin 15258 ZA.1- Klauzolat përkatëse për elementet e murit mbajtës		Nivelet dhe/ose klasat	Shënime dhe njësi
Detajet	Të gjitha metodat	4.3.1 8.	Vetitë gjeometrike Dokumentacioni teknik	-	mm
Qëndrueshmëria	Të gjitha metodat	4.3.7	Qëndrueshmëria	-	Kushtet e ambientit
Rezistenca mekanike	Metodë1	Informacioni i renditur në ZA.3.2.		-	Gjeometria dhe materialet
	Metodë 2	4.3.3	Rezistenca mekanike	-	kNm, kN, kN/m
	Metodë 3	4.3.3	Rezistenca mekanike	-	Specifikimi i dizajnit

Shtojca III

Sistemi i Vlerësimit dhe Verifikimit të Qëndrueshmërisë Performancës

Produkt(et)	Përdorimi i synuar (t)	Niveli (t) ose klasa (et)	Vërtetimi i sistemeve të konformitetit
Elementet e murit mbajtës	Strukturë/a	-	2+
<p>Sistemi 2+: Udhëzimi Administrativ Nr. 03/2019 për Kërkesat Themelore për Punimet e Ndërtimit, Deklaratën e Performancës së Produkteve të Ndërtimit, Sistemet e Vlerësimit dhe Verifikimit të Qëndrueshmërisë Performancës të Produkteve të Ndërtimit dhe Publikimin e Deklaratës së Performancës në Ueb Faqe - Neni 6: Sistemet e vlerësimit dhe verifikimit të qëndrueshmërisë së performancës, ose Rregullorja e BE-së 305/2011.</p> <p>Trupi certifikues i emëruar apo notifikuar kryen:</p> <ul style="list-style-type: none">- inspektimin fillestar të prodhimit në fabrikë dhe kontrollin e prodhimit në fabrikë;- mbikëqyrjen e vazhdueshme dhe vlerësimin e kontrollit të prodhimit në fabrikë.			